



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 2/20, DATË 01/ 08 /2023

**PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KOMITETIT TË INVESTIMEVE
STRATEGJIKE NR. 2/7, DATË 27.07.2020 DHE VENDIMIT TË KOMITETIT TË
INVESTIMEVE STRATEGJIKE NR. 2/10, DATË 04.02.2021**

Në mbështetje të Nenit 9 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu II, pika 10 të VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike” dhe Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Komiteti i Investimeve Strategjike nëpërmjet Vendimit Nr. 23/2, datë 23.07.2019 ka vlerësuar të pranojë kërkesën e propozuar nga subjekti Al Shiddi Trading Company LTD, shoqëri e së drejtës arabe, me numër regjistri themeltar 1010235319, me zyra qendrore në Riadh, Mbretëria e Arabisë Saudite, nëpërmjet subjektit Shiddi Group sh.p.k, shoqëri e regjistruar sipas të drejtës shqiptare NUIS/ NIPT L92202023J, për realizimin e projektit Tirana City Center dhe ka miratuar statusin “projekt me potencial strategjik” në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1024, datë 16.12.2015.
- Komiteti i Investimeve Strategjike nëpërmjet Vendimit Nr. 2/7, datë 27.07.2020 ka vlerësuar të miratojë kërkesën e subjekti Shiddi Group sh.p.k, shoqëri e regjistruar sipas të drejtës shqiptare NUIS/ NIPT L92202023J, për përfitimin e statusit “investim/investitor strategjik procedurë e veçantë” për realizimin e projektit Tirana City Center në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015, kushtëzuar ky vendim me plotësimin e kushteve të parashikuara në kontratën/marrëveshjen e investimit, që do të nënshkruhej ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe subjektit aplikues, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit sektorial.
- Komiteti i Investimeve Strategjike nëpërmjet Vendimit Nr. 2/10, datë 04.02.2021 ka vlerësuar të konsiderojë të plotësuar nga ana e subjektit kushtet paraprake të vendosura me Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr.2/7, datë 27.07.2020 dhe po në vijim të këtij të fundit, certifikimi i tyre do të duhej të materializohej në preambulën e marrëveshjes për investim që do të negociohej me investitorin, me nënshkrimin e deklaramit të plotësimit të parakushteve nga Ministria

e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, referuar dhe parashikimeve të legjislacionit sektorial.

- Më datë 15.12.2021, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit informon përmes një shkrese zyrtare Sekretariatit Teknik se është njoftuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë përmes një dëftese komunikimi me nr. Akti 6482, datë 01.10.2021 mbi një proces gjyqësor me të paditur Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me objekt detyrimin e palës së paditur njohjen pronar mbi sendin truall me sipërfaqe 18 458 m², në ZK 8340 Tiranë, nr. Pasurie 8/76. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bazë dhe zbatim të Nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi përfundimtar për çështjen paraprake. Pala u njoftua nga Sekretariati Teknik.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendim Nr. 1139, datë 15.03.2023 mbi çështjen civile nr. Regj.Them 12475/6842/2967/2001 ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes civile.
- Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 2/7, datë 27.07.2020 dhe Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 2/10, datë 04.02.2021, nuk kanë sjellë asnjë pasojë juridike pasi ashtu si parashikohet shprehimisht nga vetë aktet, fillimi i pasojave juridike kushtëzohej me nënshkrimin e marrëveshjes mes palëve të përcaktuara.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE VENDOSI:

1. Anulimin e Vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 2/7, datë 27.07.2020 dhe Vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 2/10, datë 04.02.2021, pasi nuk u arrit të nënshkruhej një kontratë/marrëveshje investimi ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe subjektit aplikues.
2. Nëpërmjet anulimit të Vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 2/7, datë 27.07.2020 dhe Vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 2/10, datë 04.02.2021 rivendoset ligjshmëria që Komiteti i Investimeve Strategjike të kryejë vlerësim oportuniteti mbi pasurinë në fjalë për projekte të tjera të propozuara e të cilat plotësojnë kriteret ligjore për të përfutur mbështetjen e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet subjektit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA